

Deputeti i Partisë së Veprimit Demokratik (SDA), Enis Imamovic, në Parlamentin e Serbisë foli për politikën antiboshnjake të serbëve.

Ai përmend vrasjet dhe dhunën që nuk zgjidhet. Keqbërësit që nuk ndëshkohen. Ndërsa, nuk harron edhe kërcënimet e çetnikëve, "qenve të luftës", të mercenarëve proruse në Ukrainë, që po ia bëjnë Sanxhakut, transmeton Telegrafi.

Ndër të tjera ai përmend edhe fashizmin serb, në Vojvodinën shumetnike, me sulmet ndaj pronës dhe jetëve të shqiptarëve.

Ndërkaq, përderisa deputetët serbë bëjnë zhurmë, kryetari i Kuvendit i thotë se me fjalimin e tij po irriton shumicën e deputetëve, pra serbët!

[youtube height="400" width="100%" align="none"]<http://www.youtube.com/watch?v=rSTVMJFcv7A>[/youtube]